



V E N D I M

Nr. 71, datë 22.12.2015

**“PËR KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FARMACITË DHE AGJENCITË
FARMACEUTIKE PËR LIDHJEN E KONTRATËS ME FONDIN, DHE PROCEDURAT PËR
LIDHJEN E KONTRATAVE PËR VITIN 2016”**

Në mbështetje të nenit 20, shkronja "d" të Ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në Ligjin nr. 105/2014, "Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik", në Ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, "Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope", të ndryshuar, në Ligjin nr. 9150, datë 30.10.2003, "Për Urdhërin e Farmacistëve të Shqipërisë", të ndryshuar, në Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ i Fondit:

VENDOSI:

I. Kriteret që duhet të plotësojnë Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike për të

Lidhur Kontratë me FONDIN të jenë si më poshtë:

1. Farmacia/agjencia farmaceutike të jetë e licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.
2. Farmacia/agjencia farmaceutike të jetë e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
3. Drejtuesi teknik të jetë i pajisur me certifikatë nga Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë.
4. Farmacia/agjencia farmaceutike të ketë llogari bankare.

5. Drejtuesi teknik i farmacisë/agjencisë të drejtojë vetëm farmacinë/agjencinë për të cilën është licencuar.
6. Farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar të jenë anëtarë të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë.
7. Drejtuesi teknik i farmacisë/agjencisë, farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar të kenë kontratë punësimi me pronarin/përfaqësuesin ligjor të farmacisë/agjencisë.
8. Farmacia/agjencia farmaceutike të jetë e pajisur me frigorifer për ruajtjen dhe tregtimin e barnave termolabile.
9. Farmacia/agjencia farmaceutike të jetë e pajisur me kasafortë, për ruajtjen e barnave narkotike dhe helmet e tabelës II. (Kur ajo është e licencuar t'i tregtojë ato).
10. Farmacia duhet të jetë në një distancë të tillë jo më pak se 20 metra nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor publik.
11. Farmacia/agjencia farmaceutike të jetë e pajisur me kompjuter për regjistrimin e të dhënave sipas programeve të përgatitura nga Fondi.
12. Farmacia/agjencia farmaceutike të ketë të vendosur në pjesën e jashtme të saj në mënyrë të dukshme, emrin tregtar me të cilin është regjistruar pranë QKR-së.
13. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë duhet të ketë sipërfaqe të shfrytëzueshme 50 metra katrorë (ndërsa agjencia 15 m²). (Gentplan i lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar).
14. Farmacia/agjencia farmaceutike që lidh kontratë për herë të parë, duhet të jetë në një distancë të tillë jo më pak se 150 metra, (rrugë këmbësore) nga farmacia/agjencia farmaceutike ekzistuese me kontratë (plan vendosje dhe vërtetim lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar).
15. Farmacia/agjencia farmaceutike që lidh kontratë për herë të parë ose pas një periudhe ndërprerje, të ketë gjëndje në farmaci/agjenci jo më pak se 60 % të barnave alternativa të para të listës së barnave që rimbursohen, në sasi të tillë jo më pak se sa mjekimi mujor, sipas protokollit.
16. Në mjediset e farmacisë/agjencisë nuk duhet të ushtrohet aktivitet tjetër privat ose familjar, jo farmaceutik.
17. Mjediset e farmacisë/agjencisë duhet të jenë të ndara nga ambientet e tjera private ose familjare.

18. Nuk lidhet kontratë me agjencitë farmaceutike në qytetet dhe fshatrat ku ka farmaci me kontratë.
19. Nuk lidhet kontratë me farmacitë/agjencitë farmaceutike të cilat janë në proces gjyqësor me FONDIN/Drejtorinë Rajonale të Fondit.
20. Farmacitë/agjencitë farmaceutike të cilat janë në hetim nga organi i akuzës për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate deri në përfundimin e plotë të hetimeve, nuk lidhet kontratë.

Lidhje kontrate për herë të parë do të konsiderohet në rastet kur:

- a. Farmacia/agjencia farmaceutike hyn në skemën e sigurimeve shëndetësore për herë të parë, pa patur asnjëherë kontratë të mëparshme me Fond-in.
- b. Farmacia/agjencia farmaceutike ka kontratë me Fondin, por ndryshon në të njëjtin moment NIPT/NUIS, Licencën e Aktivitetit, Pronarin dhe Drejtuesin Teknik.
- c. Farmacia/agjencia farmaceutike ka patur kontratë, por i është zgjidhur për një periudhë 1 vjeçare.
- d. Farmacia/agjencia farmaceutike ka patur kontratë, por ndryshon vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.
- e. Farmacia ndryshon aktivitetin nga agjenci farmaceutike në farmaci.

II. Procedurat për lidhjen e Kontratës

FONDI përcakton afatin e fillimit të procedurave për lidhjen e kontratës si dhe datën e hyrjes në fuqi të saj.

1. Farmacitë duhet të dorëzojnë genplan vendosje, distanca e farmacisë të jetë jo më pak se 20 metra nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor publik.
2. Farmacitë/agjencitë farmaceutike që rilidhin kontratë në vazhdim, dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale të Fond-it të rajonit ku ushtron aktivitetin:
 - a. Formularin tip të Vetëdeklarimit (i cili mund të printohet tek www.fsdksh.com.al).
 - b. Inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen.

Nëse Farmacia/agjencia me rilidhjen e kontratës në ndryshim nga viti i mëparshëm ndryshon njërin nga kriteret: a.-Licencë e aktivitetit, b.-Pronari i aktivitetit, c.-Drejtuesi teknik, d.-të punësuarit farmacistë ose nd/farmacistë, e.-NIPT-in, veç sa më lart duhet të dorëzojë dhe kopjen e dokumentit të kriterit të ndryshuar.

1. Farmacitë/agjencitë farmaceutike që lidhin kontratë pas një periudhe ndërprerje, dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale të Fond-it të rajonit ku ushtron aktivitetin:

- a) Formularin tip të Vetëdeklarimit, (i cili mund të printohet tek www.fsdksh.com.al). Të dhënat duhet të përputhen me ato të deklaruara në QKR.
- b) Kopje të licencës së ushtrimit të aktivitetit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.
- c) Kopje të certifikatës së regjistrimit tatimor, NIPT/NUIS dhe QKR.
- d) Kopje të certifikatës së ushtrimit të profesionit për drejtuesin teknik lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve.
- e) Kopjen e noterizuar të kontratës së punës ndërmjet pronarit/përfaqësuesit ligjor me të punësuarit, farmacistë ose nd/farmacistë .
- f) Kopje të certifikatës së anëtarësimit, lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve për farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar. Në rastet kur vendi i punës i farmacistit, nd/farmacistit të punësuar shënuar në certifikatën e anëtarësimit nuk përputhet me subjektin në të cilin ai do të punojë, do të kërkohet (pranohet) vërtetimi i anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (origjinal), lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve.
- g) Inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimburohen.

2. Farmacitë dhe agjencitë farmaceutike, të cilat lidhin kontratë për **herë të parë** duhet të bëjnë kërkesë me shkrim dhe të dorëzojnë pranë FOND-it, dokumentacionin sipas germave "a", "b", "c", "g" dhe "h" të mëposhtme, vetëm pas miratimit nga ana e FOND-it, të dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale të rajonit ku ushtron aktivitetin, sa më poshtë:

- a. Formularin tip të Vetëdeklarimit, (i cili mund të printohet tek www.fsdksh.com.al). Të dhënat duhet të përputhen me ato të deklaruara në QKR.
- b. Kopje të licencës së ushtrimit të aktivitetit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.
- c. Kopje të certifikatës së regjistrimit tatimor, NIPT/NUIS dhe QKR.

- d. Kopje të certifikatës së ushtrimit të profesionit për drejtuesin teknik lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve.
- e. Kopjen e noterizuar të kontratës së punës ndërmjet pronarit/përfaqësuesit ligjor me të punësuarit, farmacistë ose nd/farmacistë .
- f. Kopje të certifikatës së anëtarësimit, lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve për farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar. Në rastet kur vendi i punës i farmacistit, nd/farmacistit të punësuar shënuar në certifikatën e anëtarësimit nuk përputhet me subjektin në të cilin ai do të punojë, do të kërkohet(pranohet) vërtetimi i anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (original), lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve.
- g. Genplanin e mjedisit mbi 50m² (15m² agjencia), plan vendosjen e Farmacisë, Farmacia duhet të jetë në një distancë të tillë jo më pak se 20 metra nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor publik.
- h. Vërtetimin e distancës/largësisë mbi 150 metra nga farmacitë ekzistuese me kontratë, lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar.
- i. Inventarin e gjendjes fizike të barnave te rimbursuara.

3. Kur farmacia/agencia farmaceutike është e kontraktuar me Fond-in dhe ndryshon njërin nga të dhënat: a.-NIPT-in, b.-Licencën e aktivitetit, c.-Pronarin e aktivitetit, d.-Drejtuesin teknik, bëhet shtojcë kontrate për kriterin/kriteret e ndryshuar. Për të lidhur shtojcë-kontratën farmacia duhet të dorëzojë brenda 5 ditëve, pranë Drejtorisë Rajonale të Fond-it të rajonit ku ushtron aktivitetin:

- Formularin e Përditësimit të Vetëdeklarimit.
- Kopjen e dokumentit të ndryshuar.

Drejtorja Rajonale për lidhjen e kontratës sipas kriterëve të mësipërme duhet të ngrejë një komision prej tre anëtarësh. Përbërja e komisionit caktohet nga drejtori i Drejtorisë Rajonale.

Komisioni mban procesverbal për zbatueshmërinë e kriterëve të mësipërme nga kërkuesi dhe i paraqet materialin/dokumentacionin përkatës drejtorit të Drejtorisë Rajonale, i cili merr vendimin për lidhjen ose jo të kontratës.

Kur subjekti i interesuar plotëson kriteret dhe dokumentacionin si më lart Drejtorja Rajonale lidh kontratën brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së dokumentacionit.

Mos lidhja e kontratës duhet të argumentohet dhe t'i jepet subjektit kërkuar.

Në zbatim të këtij vendimi FONDI nxjerr udhëzimin përkatës për lidhjen e kontratave.


Të gjitha aktet e mëparshme që bien në kundërshtim me këtë Vendim, shfuqizohen.

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ILIR BEQAJ
KRYETARI I KËSHILLIT ADMINISTRATIV





FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Këshilli Administrativ

V E N D I M

Nr. 24, datë 26.06.2019

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 71 DATË 22.12.2015 TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV PËR KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË FARMACITË DHE AGJENCITË FARMACEUTIKE PËR LIDHJEN E KONTRATËS ME FONDIN, DHE PROCEDURAT PËR LIDHJEN E KONTRATËS”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 20, shkronja “d” të Ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, të ndrysh, në Ligjin nr. 10/2014 “për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”, në Ligjin nr. 7975 datë 26.7.2015 “Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope”, të ndryshuar, në Ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Këshilli Administrativ i Fondit:

V E N D O S I:

1. Në Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 71 datë 22.12.2015, kapitulli I “Kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për të lidhur kontratë me Fondin”, pika 19 shfuqizohet.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT ADMINISTRATIV

Ogerta Manastirliu

